LAJME

Rasti në Veternik, intervistohen 9 persona për plagosjen e trefishtë, i dyshuari në kërkim

Autori: Gazeta inFokus
10:16 | 13 August 2024

Tre persona kanë mbetur të plagosur dje në magjistralen Prishtinë-Ferizaj, përfshitë dy gra dhe një burrë.

Sipas policisë, fillimisht disa persona ishin përfshirë në një rrahje ku ishin përdorur edhe armët.

Si pasojë, dy gra dhe një burrë kanë marrë lëndime trupore.

-Advertisement-

Lidhur me rastin janë intervistuar 9 persona, ndërsa të lënduarit janë dërguar ne tretman mjekësor në QKUK.

Për rastin është identifikuar një person që është vënë në kërkim të policisë.

"Rr. Prishtinë-Ferizaj 12.08.2024 – 06:04. Gjatë një rrahje ku ishin të përfshirë disa persona, ishin përdorë edhe armë zjarri. Lëndime trupore kanë pësuar dy femra dhe një mashkull kosovar. Në vendngjarje në cilësi të provave materiale është gjetur dhe konfiskuar një gëzhojë. Lidhur me rastin janë intervistuar 9 persona. Të lënduarit janë dërguar ne tretman mjekësor në QKUK. Lidhur me rastin është identifikuar një i mashkull kosovar cili është në kërkim policor", thuhet në njoftim.

Për rastin dje ka dhënë detaje edhe mjeku i Emergjencës, Avdush Bajgora. Ai ka thënë se tre të plagosurit në lagjen Veternik në Prishtinë, i kanë pranuar me lëndime të pjesë të ndryshme të trupit.

Bajgora në një prononcim për media, deklaroi se pacientët janë dy femra dhe një mashkull, teksa ka thënë se njëra nga pacientet ka pasur lëndime në pjesën e krahut dhe parakrahut, ku pjesët metalike të mjetit shpërthyes janë ende prezent.

"Kemi pranuar tre pacientë, prej të cilëve një mashkull dhe dy femra me lëndime në pjesë të ndryshme të trupit nga një mjet plasës apo shpërthyes", tha Bajgora.

"Pas ekzaminimeve rengerologjike është konstatuar se njëra paciente ka pasur lëndime në pjesën e krahut dhe të parakrahut ku pjesët metalike të mjetit shpërthyes janë prezente ende në esterilitetin e saj", shtoi ai.

Tutje, Bajgora theksoi se te pacienti tjetër ka gjithashtu lëndim të krahut dhe në sy, teksa i njëjti është transferuar në klinikën e Oftalmologjisë.

Ndërsa dy pacientët e tjera janë liruar për trajtim të mëtutjeshëm me terapi.

"Pacienti është pranuar në klinikën e Oftolmologjisë, ndërsa dy pacientet e tjera janë liruar për trajtim të mëtutjeshëm me terapi në shtëpi", deklaroi Bajgora.

Po ashtu, Bajgora pohoi se të plagosurit janë në moshës së re.

Subscribe në YouTube: GAZETA INFOKUSI

MBJELLJA E FLOKËVE
30% ZBRITJE
anaderm
+383 45 707 733

Etiketa:
PLAGOSJA E TREFISHTE | VETERNIK

Coffee Show B2B në Zagreb nga Devolli Corporation

Sponsoruar

Të tjera

Vjehrra dhe vjehrri e raportojnë nusen në

Një grua dhe një burrë nga Peja kanë raportuar në Policinë e Kosovës një

U rrokullis me motor, vdes një

Një person ka ndërruar jetë dje në Novosellan pasi i njëjti ishte

LDK thërret konferencë për

Lidhja Demokratike e Kosovës do të mbajë sot konferencë për media.

Një person i lënduar dhe 20 vetura të

Një person gjersa ka qenë duke punuar nga pakujdesia ka shkaktuar

PDK-ja mban konferencë për

Partia Demokratike e Kosovës [PDK] sot pritet të mbaj konferencë për

Mblidhet Qeveria, ky është rendi i

Sot do të mbahet mahet mbledhja e Qeverisë së Kosovës. Në këtë

DASH: SHBA nuk është përfshirë në

Shtetet e Bashkuara nuk janë angazhuar në asnjë aspekt të planifikimit apo

Kryeministri i Japonisë, Kishida

Kryeministri japonez Fumio Kishida ka bërë me dije se do të japë

Parashikimi i motit në Shqipëri,

Shërbimi Meteorologjik Ushtarak bën me dije se sot (14 gusht) territori i

Zgjedhjet në SHBA në rrezik? Pas

Fushata presidenciale e Kamala Harris ka konfirmuar se ishte

Sulmi ukrainas, rajoni i Belgorodit

Guvernatori i Belgorod, një rajon rus në kufi me territorin ukrainas,

Qeveria e Kosovës vazhdon të heshtë

Minatorët e Trepçës do të protestojnë të enjten para objektit të Qeverisë për...

FOKUSI

LAJME
01 Dyshohet për shpërthim në një lagje të Pejës
LAJME
02 ASK: Ritet indeksi i qarkullimit të industrisë
LAJME
03 Moti sot me diell dhe vranësira të shpërndara
LAJME
04 Kjo është gjendja në pikat kufitare
LAJME
05 KFOR lëshon një deklaratë pas takimit me kryeministrin
LAJME
06 Latifi: Kosova ka rënë shumë poshtë në përceptimin e
LAJME
07 Kokalari: Serbët kanë filluar të kenë profil pozitiv në
LAJME
08 Dejona Mihali i përgjigjet Haradinajt, ia kujton një
LAJME
09 Hovenier: Serbia i ka bërë kërkesë zyrtare Kosovës për
LAJME
10 Kurti takohet me komandantin e KFOR-it,

LAJME

PSD-ja mbështet protestën e minatorëve të Trepçës që mbahet të enjten

Lajmërohet Petkoviq: Edhe kur SHBA dhe anëtarët tjerë të QUINT paralajmërojnë

Kryeziu: Nëse hapja e urës mbyllë urat e bashkëpunimit me aleatët, do të mbahemi të

Vulini e falënderon Moskën për "paralajmërimin për tentim-puç" në Serbi

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara © 2012-2018 Infokusi